



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti na

30-06-2022

01-MO/05-661

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2, lidhur me piken 6 të Ligjit për Dhënie e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Nr.06/L-092, nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2022 merr këtë:

VENDIM

për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komisioni për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër të Komunës së Vitisë. Njësia kadastrale me Nr.P-70101038-01724, vendi i quajtur "Rashita", me sipërfaqe prej 1834 m², në Zonën Kadastrale në Smirë, Komuna e Vitisë. Komisioni propozohet prej 5 anëtarëve; dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile, dhe atë:

- Xhelal Shaqiri, anëtar i komisionit (përfaqësues i ekzekutivit të Komunës);
- Sebahate Metallari, anëtar i komisionit (përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës);
- Veton Ramadani (përfaqësues i kuvendit të komunës subjekti PDK);
- Reshat Azizi (përfaqësues i kuvendit të komunës subjekti AAK);
- Melihate Osmani (përfaqësues i sektorit joqeveritar).

Neni 2

Me këtë vendim, detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019). Komisioni vlerësues udhëheq me procedurat mbi dhënie e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim si: përgatit kriteret e ankandit, përcakton çmimin fillestar, vlerëson ofertat dhe ja propozon kuvendit ofertën më të favorshme. Njësitë përkasë të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit, drejtorive;
2. Anëtarëve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI
Bekim Azizi

